



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr.1276/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P “SPORTING “ B.I , me seli në Prizren, rr. “Jonit”, p.n. NUI 810577835, të cilin me autorizim e përfaqëson V.O., avokat nga Prizreni, kundër debitorit N.N.SH. P&I/ I.E. B.I. me seli në Komunën e Kaçanikut, me NRB 810302191, të cilin me autorizim e përfaqëson J.F.B. avokat nga Ferizaji, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2210/22 të datës 28.07.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit N.P “SPORTING “ B.I , ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2210/22 të datës 28.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2210/22 të datës 28.07.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N.N.SH. P&I/ I.E. B.I. me NRB 810302191 , ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.704/21, i datës 03.02.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha me seli të zyrës në Prizren ashtu që është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2210/22 të datës 28.07.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P “SPORTING “ B.I me datën 03.02.2021 ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë në bazë të dokumentit - Faturë me numër: nr.287, e datës 31/12/2018, ka lejuar përmbartimin me Urdhrit Përmbartimor P.nr.704/21, të datës 03.02.2021, me të cilin është urdhëruar të gjitha bankat që operojnë në Republikën e Kosovës që ti sjellin transaksionet bankare për kreditorin ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare të gjitha bankave dhe shuma e kërkuar së bashku me shpenzimet e përmbartimit dhe shuma e përcaktuar të barten nga llogaria e debitorit, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej ditës së dorëzimit të propozimit deri në pagesën definitive, shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.704/21 dt.03.02.2021 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor Debitori, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se nga kartela e kreditorit shihet qartë se kreditori ka lëshuar disa herë fatura për shumat e njëjta, shuma prej 57,000.00 € është faturuar edhe në faturat 114,142, 11/2018 dhe 12/2018 ku shihet se shuma prej 57,000.00 është përfshirë përsëri. Tutje shton se nga faturat shihet se te përshkrimi i mallit në faturat e mëhershme është shënuar vetëm kodi i produktit, ndërsa në dy faturat me nr.287, është shënuar edhe 6 rende me montim, andaj shihet qartë se faturat dallojnë esencialisht edhe pse përmbajnë të njëjtin numër, datë dhe kërkesë. Tutje sqaron se kishte fituar tenderin për ndërtimin e Palestrës Sportive në Shtime, të autoritetit kontraktues KK Shtime. Sipas paramanave ishte parashikuar të vendosen 9 rende me tribina teleskopike dhe ofertën e parë nga kreditori e ka bërë për 9 rende në shumë prej 89,845.50 €, mirëpo gjatë implementimit të projektit për shkak të mungesës së hapësirës së sallës sportive, përkatësisht ngushtimit të hapësirës, është vendosur nga menaxherët e projektit që të mos vendosen 9 rende por 6 të tribinave teleskopike. Tutje shton se për shkak të këtij ndryshimi kreditori dhe debitori ishin dakorduar që shuma totale për 6 rende të jetë 57,000.00 € dhe e njëjta është paguar, andaj shuma e kërkuar prej 32,845.60 € është e pa qenë dhe se dokumentet përmbartimore janë fiktive. Po ashtu duke u bazuar në nenin 260 të LPP-së debitori konsideron se përmbartuesi duhet të shtynë përmbartimin deri në përfundimin e procesit kontestimor. Ka kërkuar të miratohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbartimor të anulohet dhe refuzohet propozimi për përmbartim si dhe të obligohet kreditori që debitorit ti paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe të gjitha shpenzimet tjera, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabaza dhe ka theksuar se të njëjtat kanë për qëllim prolongimin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin

nga puna juridike e vlefshme. Shton se debitori në kundërshtim me faktet e pretenduara, vërteton faktin se në mes të palëve ka pasur një raport juridik lidhur me furnizimin e pajisjeve sportive për palestrën sportive në Komunën e Shtimes. Në kundërthënie të pretendimeve në prapësim me faktin e ekzistimit të një raporti juridik, debitori thirret se kontrata nuk është e nënshkruar ndërsa në anën tjetër thirret në realizimin e të drejtave dhe 3 obligimeve në mes të palëve që dalin nga kjo kontratë përkatësisht vendosja e 6 rendeve të tribunave teleskopike që dalin si rezultat i kësaj kontrate. Tutje thekson se fakti i ndryshimit të rendeve të tribunave teleskopike është përcaktuar gjatë realizimit të kontratës, dhe çmimi i përcaktuar në faturë është për 6 rende, pasi që fatura është përpiluar pas precizimit të kërkesave nga palët. Nga gjykata kërkoi ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2210/22 të datës 28.07.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N.N.SH. P&I/ I.E. B.I. me NRB 810302191 , ndërsa ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.704/21, i datës 03.02.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli të zyrës në Prizren ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti - fatura nr. 287 e datës 31.12.2018, në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta të jetë pranuar nga debitori. Gjykata vlerëson se e-maili i dërguar nga kreditori tek debitorit nuk është provë e mjaftueshme se fatura është pranuar. Në mungesë të konfirmimit të faturës së pranuar nga debitori përmes emailit që i është dërguar nga kreditori, një pretendim i tillë duhet të refuzohet.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 në par.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është disponues për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura nr. .287, e datës 31/12/2018, si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, njëjta nuk është e vërtetë e as nënshkruar nga debitori, ndërsa emaili i dërguar nga kreditori drejtuar debitorit nuk është provë e mjaftueshme pasi që debitori nuk ka konfirmuar pranimin e emailit, andaj, në këtë mënyrë fatura nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit lidhur me ekzistimin e kontratës në mes të palëve dhe se çmimi është precizuar gjatë realizimit të kontratës, mirëpo vlerësoi se kontrata nuk është nënshkruar nga debitori ndërsa edhe po të ishte nënshkruar në këtë fazë në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Sa i përket provave të bashkangjitura në ankesë nga kreditori dhe atë dëshmisë bankare për faturën nr.100/18004147 përmes së cilës debitori ka realizuar pagesa, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se fatura në fjalë nuk është kërkesë për lejimin e përmbartimit nga kreditori në këtë procedurë përmbartimore.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk II.nr.1276/23, me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami